



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 7. Stefan Mano, Specialist pranë Drejtorisë së Investimeve dhe Planifikimit Strategjik.**

#### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rishpërndarjen e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Përsëritje!

Po fillojmë mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 13 mars.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës sot janë rreth 9 çështje, për të cilat kërkohet vendimmarrja e Këshillit. Zoti Kurushi sot është në pamundësi objektive, për shkak të arsyeshme nuk është sot prezent në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, pa humbur kohë, fillojmë me çështjen e parë nëse s’keni diskutime mbi rendin e ditës.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për rishpërndarjen e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), në disa gjykata” i cili është përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Si rezultat i ristrukturimit të gjykatave të apelit dhe fillimi i funksionimit të Gjykatës Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe për miradministrimin e mjeteve të transportit deri dhe në pronësi të tyre, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë administruar të 11 (njëmbëdhjetë) automjetet dhe një motoçikletë.

Struktura përgjegjëse (Drejtoria e Investimeve) për administrimin dhe menaxhimin e aktiveve në KLGJ, bëri një analizë të gjendjes së mjeteve të transportit në gjykata dhe kërkesave të ardhura nga gjykatat, gjatë hartimit të kërkesave të buxhetit afatmesëm 2023-2025, për sistemin gjyqësor.

Bazuar në këtë analizë, por edhe në gjendjen e përgjithshme teknike të këtyre mjeteve, është vlerësuar shpërndarja e mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikletë), si më poshtë vijon.

- Në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të transferohen 2 (dy) automjete, pasi ajo aktualisht ka në përdorim të saj 2 automjete: Scoda Oktavia prodhim i vitit 2015 dhe Mercedes Benz prodhim i vitit 2009. Kjo gjykatë me shkresën nr.339, datë 09.02.2023, ka paraqitur kërkesë për dy automjet shtesë, duke qenë tashmë e vetmja gjykatë apeli në vend dhe me një staf më të madh dhe nevoja në rritje.

- Në Gjykatën e Lartë, të transferohet 1 automjet, pasi aktualisht ka me defekt një automjet i një anëtari.

- Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të transferohen 2 automjete, pasi ajo aktualisht ka në dispozicion vetëm 6 automjete, ku për një prodhim të vitit 1999, gjykata do të fillojë procedurën e vlerësimit për ta nxjerrë nga përdorimi. Gjykata ka paraqitur kërkesë në PBA për 4 automjete, duke parashikuar plotësimin e shpejtë të numrit të trupës gjyqësore (Organika e GJKKO-së është 16 gjyqtarë) dhe për të rritur shkallën e sigurisë fizike, (shpesh gjyqtarët janë nën shoqërimin dhe ruajtjen fizike të oficerëve të repartit special të policisë, “RESI”).

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të transferohet 1 automjet, pasi ajo aktualisht ka në dispozicion vetëm dy automjete Skoda “Oktavia” prodhim i vitit 2015 dhe Mercedes Benz “C class” prodhim i vitit 2005. Gjykata ka paraqitur kërkesë në PBA 2023-2025, për një automjet.

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, të transferohet 1 automjet, pasi ajo

aktualisht ka dy automjete Ford Fokus 1,5 prodhim i vitit 2016 dhe Wolswagen Bora prodhim i vitit 1999. Kjo gjykatë nuk ka paraqitur kërkesë për automjet.

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, të transferohet 1 automjet, pasi ajo aktualisht ka në përdorim 2 automjete; Opel Astra prodhim i vitit 2017 dhe Ford Fokus prodhim i vitit 2003.

Kjo gjykatë nuk ka paraqitur kërkesë për automjet tjetër por vlerësojmë se transferimi i një automjeti tjetër do të përmirësonte situatën e transportit dhe në kuadrin e hartës së re gjyqësore.

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër të transferohet 1 automjet, pasi ajo aktualisht ka në përdorim 2 automjete: Hyunday “Elantra” prodhim i vitit 2018 dhe Wolswagen “Bora” prodhim i vitit 1999. Edhe kjo gjykatë nuk ka paraqitur kërkesë por është vlerësuar nga departamenti.

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë të transferohet 1 automjet, pasi ajo aktualisht ka në pronësi të saj 3 automjete: Hyunday “Elantra” prodhim i vitit 2018, Wolswagen Bora prodhim i vitit 1999, dhe Mercedes Benz prodhim i vitit 1990, ku për të dy automjetet e fundit gjykata ka plotësuar procedurat e vlerësimit për nxjerrje nga përdorimi, të cilat janë dorëzuar në KLGJ dhe pritet miratimi për nxjerrje nga përdorimi. Kjo gjykatë ka kërkuar në PBA 2023-2025, një automjet tjetër. Kjo kërkesë është përsëritur zyrtarisht edhe në shkurt të këtij viti.

- Në fund mbetet për tu vlerësuar transferimi i dy automjeteve Lincoln LC prodhim i vitit 2002 e Gjykatës Apelit Shkodër dhe Hyunday Elantra prodhim i vitit 2003 e Gjykatës së Apelit Vlorë, duke qenë se këto dy automjete nuk janë në gjendje të mirë teknike shoqëruar dhe me vështirësitë e mirëmbajtës së tyre, vlerësojmë që të transferohen në gjykatat e rretheve përkatëse gjyqësore, për të bërë në vazhdim vlerësimin e tyre për nxjerrje nga përdorimi, ku automjeti “Linkoln” të transferohet në Shkodër dhe automjeti tip Hyunday Elantra të transferohet në Vlorë.

- Ndërsa, për sa i përket motoçikletës, vlerësojmë se ajo mund të transferohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ajo ka dhe një numër të madh ftuesish gjyqësorë.

Për sa më sipër, ky është edhe vlerësimi që ka bërë departamenti dhe i ka propozuar Komisionit dhe më pas Komisioni e ka miratuar.

Nëse keni ndonjë pyetje apo kërkoni informacion shtesë mbi gjendjen, kemi specialistin e departamentit që është marrë me këtë.

(Anëtarët nuk kanë pyetje apo diskutime.)

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes së mjeteve të transportit (autovetura dhe motoçikleta), sipas nevojave të disa gjykatave, sipas pasqyrës bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 7. Stefan Mano, Specialist pranë Drejtorisë së Investimeve dhe Planifikimit Strategjik.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve, në disa gjykata”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

**Naureda Llagami:** Kalojmë edhe tek projekt-akti i dytë, i cili ka të bëjë me miratimin për nxjerrjen nga përdorimi të disa aktiveve në disa gjykata.

Kjo është një praktikë në fakt e konsoliduar e Këshillit ku gjykatat nëpërmjet komisioneve nxjerrin nga përdorimi asetet që ato kanë, që mund të jenë kompjuterë, pajisje elektronike, pajisje zyre, pajisje sigurie, etj. Procedura është që pasi krijojnë një komision, kjo procedurë kontrollohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kemi një relacion të detajuar. Ne propozojmë gjithmonë në mbledhje plenare pasi mbledhim disa gjykata të cilat kanë zhvilluar nxjerrjen nga përdorimi të aseteve të tyre.

Nëse kërkoni ndonjë detajim për ndonjë gjykatë konkrete, kemi specialistin këtu. Pa dashur të kaloj në përsëritje, sepse është e njëjta procedurë; është bërë në Gjykatën e Apelit Tiranë, Apelit Gjirokastrë, Apelit Vlorë, Apelit Korçë, Apelit Shkodër. Në

kuadrin edhe të hartës gjyqësore ato kanë ndërmarrë këtë procedurë. Më pas kemi edhe gjykatat e rretheve Durrës, Dibër, Tropojë, Lushnjë, Mat, Gjirokastër, Elbasan, Pukë, Berat, shkalla e parë administrative Tiranë, Kurbin, Vlorë, shkalla e parë administrative Korçë. Kryesisht janë pajisje që datojnë prej kohësh të blera nga gjykatat.

Ndonjë pyetje?

(Anëtarët nuk kanë pyetje apo diskutime).

Nëse nuk keni, atëherë kalojmë në miratimin e aktit të propozuar nga Komisioni.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve në ish-Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, (sipas pasqyrave bashkëlidhur nga nr. 1 – nr. 11).

2. Miratimin e nxjerrjes nga përdorimi të disa aktiveve në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Gjirokastër, Vlorë, Korçë, Kurbin, Berat, Lushnjë, Mat, Pukë, Elbasan, Fier, Durrës, Tropojë dhe Dibër, si dhe Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Korçë, (sipas pasqyrave bashkëlidhur nga nr. 1 – nr. 29).

3. Gjykatat e sipërcituara, ngarkohen të vazhdojnë procedurat e mëtejshme sipas përcaktimeve të legjislacionit për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.

4. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale, projekt-akt i cili do relatohet nga zoti Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit!

Po ju parashtroj relacionin mbi projektvendimin “Për transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 51, datë 27.01.2023, ndër të tjera ka vendosur:

“1. T’i kërkojë gjyqtarit z. {...}, të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes për t’u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e të njëjtit nivel e së njëjtës lëndë me pozicionin e mëparshëm, si më poshtë:

i) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës civile;

ii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në fushën e së drejtës penale;

iii) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës civile;

iv) Një pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në fushën e së drejtës penale.

2. E drejta e zgjedhjes sipas pikës 1 duhet të ushtrohet brenda 3 (tre) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Ky vendim ishte pasojë e vendimmarrjes fillestare të Këshillit, pasi z. {...}, bazuar në vendimin nr. 130, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhoma penale, si i transferuar pa pëlqim.

Për shkak të statusit të veçantë si gjyqtar i gjykatës për Krime të Rënda, Këshilli është detyruar të ndër marrë disa vendime për z.{...} pas shprehjes së organeve të rivlerësimit.

Pas shpalljes së vendimit të KPK-së, për shkarkimin nga detyra të tij, Këshilli ka vendosur deklarimin e mbarimit të caktimit të përkohshëm të gjyqtarit z. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bazuar në nenin 162, pikat 1, 3 dhe 4, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pas vendimmarrjes së KPA-së, e cila e ndryshoi vendimin e KPK-së, duke konfirmuar statusin e magjistratit për z. {...}, Këshillit i lind detyrimi të kryejë një transferim pa pëlqim për z.{...}, bazuar në ligjin nr. 96/2016 të sipërcituar.

Nga ana tjetër z. {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t’u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e shkallës së parë me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja “b”, e Ligjit nr.96/2016.

Komisioni, referuar pikës 2 të vendimit nr. 51 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosi të njoftojë z. {...} mbi të drejtën për të zgjedhur për t'u transferuar në një nga pozicionet e lira të përhershme në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të ofruara nga Këshilli.

Ky njoftim u realizua me datë 31.01.2023, protokolluar me aktin nr.503/2 protokolli.

Me shkresën kthim përgjigje datë 06.02.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr. {...} prot., datë 08.02.2023, z. {...}, ngre një sërë problemesh si më poshtë vijon:

“Si pasojë e vendimmarrjes së padrejtë të KPK-së, aktualisht krahas moskonfirmimit në detyrë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, siç parashikon neni 162, pika 7 e ligjit nr. 96/2016, më është ulur edhe paga dhe përfitimet e tjera financiare si magjistrat, situatë që është haptazi në kundërshtim me nenin 22 pika 1 të ligjit nr. 96/2016. Para vendimit të KPK-së kam përfituar pagën e grupit G2 dhe shtesë për vështirësi pune në masën 60% të pagës bruto fillestare (plus elementët e tjerë të pagës që parashikohen në nenin 12, pika 5 të ligjit 96/2016), ndërsa aktualisht përfitoj pagën e grupit G1. Këto elementë ndikojnë drejtpërdrejtë edhe në përfitimet e tjera financiare që në përputhje me ligjin më njihen si magjistrat gjatë, por edhe pas mbarimit të statusit të magjistratit. Gjithashtu sot, gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përfitojnë pagën e grupit G2 dhe shtesë për vështirësi pune në masën 80% të pagës bruto fillestare, pagë të cilën unë sot nuk e përfitoj pikërisht për shkaqet e sipërpërmendura.

Për më tepër lidhur me pagën dhe përfitimet e tjera financiare i jam drejtuar KLGJ-së edhe me kërkesën datë 12.10.2022, protokolluar në KLGJ në të njëjtën datë për të më njohur të drejtën që parashikon neni 22, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, por deri më sot nuk është kthyer përgjigje. Për këtë çështje edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën {...} prot., datë 06.10.2022 i është drejtuar KLGJ-së dhe në dijeninë time nuk i është kthyer përgjigje.

Sa më sipër nga vendimi i KPK-së janë cenuar padrejhtësisht në dy drejtime të mënyrë të njëkohshme, së pari nga zbritja në detyrë dhe së dyti nga zbritja në nivelin e pagës dhe përfitimeve të tjera financiare si magjistrat.

Ndodhur në këto kushte, kërkoj të më njihen dhe rikthehen të gjitha të drejtat, si në drejtimin e karrierës në të njëjtin pozicion ose në një pozicion të barasvlershëm me të për nga pikëpamja e ngritjes në detyrë, ashtu edhe në drejtim të pagës dhe përfitimeve të tjera financiare.

Nëse situata ime vlerësohet e pazgjidhshme nga KLGJ-ja, në pamundësi për të ushtruar detyrën në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar bëj me dije se për shkak të vendbanimit tim e të familjes sime në qytetin e Tiranës dhe fushës së të drejtës në të cilën jam specializuar (e drejtë penale), pozicioni i lirë i përhershëm në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është më i përshtatshëm për mua.”

Për sa më lart, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për transferimin e gjyqtarit {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale”. Gjithashtu për çështjet e tjera të adresuara, një kopje e shkresës i drejtohet Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit.

Struktura e projektvendimit -

Projektvendimi është strukturuar në 3 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimit propozohet transferimi i gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave ligjore.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se kundër vendimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë dhe publikimi i vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në një pozicion të lirë në fushën e së drejtës penale.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 4 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)



**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, i cili do të raportohet nga zoti Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Faleminderit!

Po parashtroj relacionin mbi projektvendimin “Për mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar kërkesa datë 22.02.2023 nga gjyqtari z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, nëpërmjet të cilës ka vënë në dijeni, mbarimin e statusit të magjistratit, si shkak i mbushjes së moshës për pension pleqërie.

Zoti {...}, i datëlindjes 05.03.1956, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 26.03.1994 (kurs i plotë i përsheptuar).

Me vendim nr. {...}, datë 28.12.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet ndihmësgjyqtar efektiv në Gjykatën e Rrethit Laç.

Me vendim nr. {...}, datë 08.02.1996 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë emërohet gjyqtar në Gjykatën e Rrethit {...}.

Me procesverbal të Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, në datë 07.01.2019 zgjidhet Zëvendëskryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, funksion të cilin e ka ushtruar deri në datë 25.01.2022 ku në këtë pozicion zgjidhet z. Arapi, dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 29 vite.

Zoti Miri nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”, në nenin 64 të tij, parashikon kohëzgjatjen në detyrë të magjistratit. Një ndër rastet e mbarimit të statusit të magjistratit është edhe kur mbush moshën për pension. Konkretisht neni 64, pika 1 citojmë si më poshtë:

1. “Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: a) jep dorëheqjen; b) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji; etj.

Ndërsa në pikën 5 të po këtij neni, parashikohet se:

5. “Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. Magjistrati, me kërkesën e tij, mund të qëndrojë në detyrë deri në moshën 70 vjeç. Kërkesa për qëndrimin në detyrë paraqitet jo më vonë se 6 muaj përpara plotësimit të moshës për pension. Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ose moshën 70 vjeç, në rastet kur ka kërkuar të qëndrojë në detyrë deri në këtë moshë. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

Kjo dispozitë ligjore, ngarkon Këshillin e Lartë Gjyqësor me përgjegjësinë për deklarimin me vendim, të mbarimit të statusit të magjistratit në rastin e plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj për të dalë në pension.

Nga dokumentet e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, rezulton se z. {...} është i datëlindjes 05.03.1956. Për rrjedhojë ai mbush moshën për pension pleqërie 67 vjeç. Për rrjedhojë, në rrethanat kur kërkesa e për mbarimin e statusit, plotëson kushtet e pikës 1 dhe 5 të nenit 64 të Ligjit për Statusin, është vendi që Këshilli i Lartë Gjyqësor të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Miri, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

Lidhur me efektet juridike, bazuar në pikën 5, të nenit 64, të Ligjit për Statusin, Këshilli deklaron me vendimin mbarimin e statusit jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.

Në këtë rast, mosha për pension pleqërie më arrihet 05.03.2023, e për rrjedhojë efektet e këtij vendimi parashikohen në 31.03.2023.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë parashikohet deklarimi i mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

Në pikën e dytë parashikohen efektet juridike, të cilat fillojnë më datë 31.03.2023.

Në pikën e tretë parashikohet komunikimi i këtij vendimi. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave ligjore, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Në pikën vijuese parashikohet e drejta e ankimit, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Në pikën e fundit parashikohet dhe hyrja në fuqi dhe publikimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

*Naureda Llagami:* Faleminderit!

Atëherë, data që keni propozuar është 31 mars?

Ok!

Kemi ndonjë diskutim?

Po!

**Brikena Ukperaj:** Faleminderit zonja Kryetare!

Nuk kam diskutim për përmbajtjen e projekt-aktit. Jam dakord. Por duke marrë parasysh që ne të gjithë jemi dakordësuar pas një e-maili të dërguar nga zonja Shehu që të gjitha aktet e Këshillit nuk do të botohen më të anonimizuara, me përjashtim të vlerësimeve, në pikën 2 të hiqet grupimi i fjalëve të fundit “pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit”, duke qenë se kemi rënë dakord që tashmë të gjitha vendimet nuk do të jenë të anonimizuara, për transparencë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Dakord, e heqim.

Kalojmë në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

Merr fjalën zonja Shehu.

**Marçela Shehu:** Kur është kërkuar miratimi, është kërkuar për njoftimet për shtyp. Njoftimet për shtyp nuk do të jenë të anonimizuara, ndërsa vendimi i zbardhur, nëse do ketë të tillë që do publikohet në faqe, do t'i nënshtrohet rregullave të anonimizimit. E-maili që kam dërguar unë është diskutuar vetëm në lidhje me njoftimet për shtyp. Pastaj këtë gjënë tjetër le ta vendosim.

**Naureda Llagami:** Atëherë, e hedhim në votim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 31.03.2023.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarin e emëruar më datë 06.03.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2019-2022”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Illir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

**RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarin e emëruar më datë 06.03.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2019-2022”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarin e emëruar më datë 06.03.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2019-2022. Për më shumë detaje, fjalën ia jap sërish zotit Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Atëherë po filloj relacionin mbi projektvendimin “Për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarin e emëruar më datë 06.03.2023, të diplomuar në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2019-2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi përfundoi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit për magistratë, profili gjyqtar,

të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022, bazuar në vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, në mbledhjen plenare të datës 06.03.2023, bëri emërimin e tij si gjyqtar, mbështetur në nenin 35 të ligjit nr.96/2016.

Ndërkohë, në ushtrim të përgjegjësisë dhe të funksionit të përcaktuar në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të detyrimit të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të shpall pozicionet e lira për gjyqtarët e emëruar më datë 20.07.2022.

Për këtë shkak, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin, “Për shpalljen e pozicioneve të lira për të emëruarin z. {...}, të diplomuar në përfundim të programit të formimit fillestar 2019-2022”.

Në pikën 1 të projektvendimit, përcaktohet pikërisht shpallja e pozicioneve të lira për të diplomuarin z. {...} në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar 2019-2022.

Në pikën 3 të projektvendimit, parashikohet e drejta e të emëruarit, referuar pikës 3 të nenit 35, si dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 36, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për të përcaktuar, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të projektvendimit, për të cilat ai kërkon të caktohen.

Në pikën 4 të projektvendimit, parashikohet detyrimi i të emëruarit, referuar nenit 8 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për deklarimin e situatës së papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3 të kësaj dispozite ligjore.

Më tej, në pikën 5 të projektvendimit parashikohet afati i aplikimit nga të emëruarit, afat ky që është përcaktuar, pra është lënë pa datë, që vlerësohet i mjaftueshëm për të paraqitur preferencat e tij.

Në këtë pikë të projektvendimit është përcaktuar edhe se mungesa e aplikimit, pra



mungesa e paraqitjes së preferencave nga të emëruarit, nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit të tij në pozicion.

Në pikën 6 të projektvendimeve përcaktohen dokumentet që i emëruari duhet të dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet; ii) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas parashikimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në projektvendim është përcaktuar që pozicionet e lira janë si më poshtë:

- i) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- ii) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë;
- iii) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- iv) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Ndërsa afati është lënë i papërcaktuar, por besoj që afati 5-ditor është i mjaftueshëm për t’i dhënë kohë.

(Anëtarët diskutojnë rreth afatit dhe bien dakord për datën 17 mars.)

**Naureda Llagami:** Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Atëherë, propozimi është që t’i lihet afat deri më datë 17 mars.

Kalojmë në votim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarin në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022 dhe të emëruar gjyqtar më datë 06.03.2023.

2. Pozicionet e lira janë si më poshtë:

- i) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- ii) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë;
- iii) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- iv) një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet;

3. I emëruari sipas pikës 1 të këtij vendimi ka të drejtë të përcaktojë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

4. I emëruari sipas pikës 1 të këtij vendimi ka detyrimin të deklarojë situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Afati i aplikimit është deri më datë 17.03.2023. Mungesa e aplikimit nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarit.

6. Në momentin e aplikimit, i emëruari sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të dorëzojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor këto dokumente:

i) Një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale, tre gjykata nga ato sipas pikës 2 të këtij vendimi, në të cilat kërkon të caktohet.

ii) Një vetëdeklarim me shkrim, sipas Shtojcës së këtij vendimi, ku të deklarojë nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të nenit 8, pika 3, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 6 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projekt-opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

<sup>1</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7-ta sipas rendit të ditës.

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projekt-opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Dritan Hallunaj, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë tek opinionimi mendoj unë, sepse këtë që kemi short e lëmë në fund. Kështu që, kemi projekt-opinionit mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Sërish fjalën ia jap zotit Hallunaj.

**Dritan Hallunaj:** Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 79, shkronja “b”, dhe 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 8, 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, me bashkëproponim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr. 44, datë 27.01.2023 ka

29

vendosur: “Hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për 1 (një) pozicion “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është data 13 shkurt.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kanë paraqitur kërkesë 2(dy) candidate.

Me shkresën nr. 1105, datë 08.02.2023, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Zonja {...} ka shfaqur vullnetin për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Me shkresën nr. 1278, datë 13.02.2023 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Zonja {...} ka shfaqur gjithashtu vullnetin për t’u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin”.

Në vendimin nr. 44, datë 27.01.2023 të Këshillit, konkretisht në Kreun II të tij, është përcaktuar edhe procedura që do të ndiqet nga Këshilli.

Konkretisht në pikën 6, Kreu II të këtij vendimi parashikohet “Brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më shumë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij.”

Në pikat vijuese të këtij Kreu parashikohet procedura e mëtejshme që ndiqet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kritereve të përparësisë së kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi sipas pikës 6 të këtij Kreu. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale brenda dy

30

javëve i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku përcaktohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kriterëve të kandidimit përfshirë edhe atyre preferenciale bashkë me renditjen e tyre, duke filluar nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrin e kandidatit të renditur më lart.

Brenda një jave nga paraqitja e raportit dhe propozimit për komandim, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor thërret mbledhjen plenare, për të vendosur në lidhje me komandimin e gjyqtarit kandidat në pozicionin e mësipërm.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për kandidatin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Në rast të mosmiratimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër që plotëson kriteret e komandimit. Ky propozim i nënshtrohet votimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

#### Vlerësimi i Komisionit:

Në respektim të procedurës që duhet të ndiqet sipas vendimit nr. 44, datë 27.01.2023, të Këshillit, në fazën e parë, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin.

Në këto rrethana Komisioni i Zhvillimit të Karrierës harton projekt-opinionin për kandidatet: {...} dhe {...}.

Në përgatitjen e këtij opinionin për këto candidate, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, verifikon, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kushteve ndaluese si dhe vlerëson cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit të gjykatës ku ushtron detyrën gjyqtari që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit.

a. {...}:

Kriteret e komandimit përcaktohen në nenin 53, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Po ashtu kriteret të posaçme përcaktuar në pikën 3, Kreu II të vendimit të Këshillit nr. 44, datë

27.01.2023. Konkretisht, në këtë pikë të këtij vendimi përcaktohet se: “Kriteret e komandimit janë:

- a) Kandidati të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë si gjyqtar;
- b) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- ç) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;
- d) Kandidati që ka qenë i komanduar më parë, duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
- dh) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.
- e) Kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Lidhur me kriteret e komandimit sipas shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, “dh” të pikës 3, të vendimit të sipërcituar të Këshillit, sipas informacionit të marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbështetur në të dhënat e dosjes personale të kandidatit, rezulton se:

Zonja {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 27.06.2011 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.

Me vendim nr. 1, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtar.

Me vendim nr. 42, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}, ku dhe aktualisht ushtron detyrën.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite.

Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me kriteret e komandimit - kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, znj. {...} ka nënshkruar vetëdeklarimin datë 08.02.2023 sipas të cilit: “Nuk do të ndodhem në kushtet e papajtueshmërisë ambientale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Sekretarin e Përgjithshëm ose gjyqtarët e tjerë të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas



parashikimeve të nenit 8, pika 1, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatja {...} dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Në këto kushte, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi dhe plotësohen kriteret specifike të kërkuara nga Këshilli.

b. {...}:

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, janë të njëjtat kritere që janë mbajtur parasysh, pra

a) Kandidati të ketë të paktën 3(tre) vjet vjetërsi;

b) Komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e gjykatës, etj.

Zonja {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës në datë 09.07.2009 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

Me dekret nr. {...}, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës caktohet përkohësisht për të kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekret nr. {...}, datë 25.09.2015 të Presidentit të Republikës emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Me vendim nr. 209, datë 20.05.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i miratohet kërkesa për leje prindërore për periudhën qershor 2021-dhjetor.2021.

Me vendim nr. 595, datë 23.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i miratohet kërkesa për zgjatje të afatit të lejes prindërore, deri në datë 31.07.2022.

Me vendim nr. 268, datë 19.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i miratohet kërkesa për zgjatje të afatit të lejes së papaguar prindërore, deri në datë 31.03.2023.

Me vendim nr. 442, datë 01.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i ndërpritet leja e papaguar prindërore, dhe në vijim ushtron funksionin e magjistratit (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite.

Zonja {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Lidhur me kriteret e komandimit - kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambientale, znj. {...} ka vetëdeklaruar datë 13.02.2023 se: “Nuk ndodhem në kushtet e papajtueshmërisë ambientale sipas parashikimeve të nenit 8 pika 1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatja {...} dhe dokumentet në dosjen personale rezulton se plotësohen kriteret e komandimit.

Në këto kushte, për këtë gjyqtare, nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi dhe plotësohet kriteret specifike të kërkuara nga Këshilli.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës:

Sa i përket cenimit apo dëmtimit të funksionalitetit (interesit të lartë) të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, nga raportimet periodike dhe informacioni e mendimi i marrë nga zëvendëskryetarja e gjykatës respektive, (të dy kandidatet ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier) rezulton se:

“Ju bëj me dije se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, aktualisht e ka organikën me 14 gjyqtarë, por aktualisht ushtrojnë funksionet pranë kësaj gjykatë 11 të tillë.

Gjyqtare znj. {...} është me leje të papaguar deri në datë 31.05.2023;

Gjyqtare {...} ka rifilluar punën ne date 01.11.2022;

Gjyqtarët {...}, {...}, {...} dhe {...} kanë filluar punë në datë 26.07.2022. Bashkëlidhur është edhe ngarkesa për secilin gjyqtar të kësaj gjykate, ku: z. {...} ka 219 çështje në shqyrtim, {...} 65, {...} 123, {...} 154, {...} 157, {...} 0, {...} 132, {...} 140, {...} 122, {...} 219, {...} 157.

Sa më sipër, duke mbajtur parasysh qëllimin e komandimit pranë KLGJ-së, si dhe rrethanat profesionale dhe familjare të gjyqtareve, mendoj se komandimi nga ana e Këshillit, nuk do të sillte cenimin e funksionalitetit të Gjykatës.”

Në kushtet e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. {...} ose znj. {...}, gjyqtare të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Fier, përballë ngarkesës së çështjeve që ka kjo gjykatë dhe numrit aktual të gjyqtarëve që ushtrojnë efektivisht detyrën pranë gjykatës respektive, sikundër dhe pritshmërisë pozitive që do të sjellë zbatimi i hartës së re gjyqësore, nuk passjell cenim të interesave të larta të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për sa kohë funksionaliteti i saj do të vijojë të ruhet.

Në datë 08.03.2023, në rrugë elektronike znj. {...}, ka komunikuar kërkesën për heqje dorë nga kandidimi për pozicionin e komanduar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u shprehur se: “Duke qenë se në datën 06.03.2023 më është njoftuar vendimi mbi transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkoj të paraqesë kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi në pozicionin e këshilltarit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Për sa më sipër, procedura e komandimit për pozicionin “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, do të vijojë për kandidaten znj. {...}.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Vijimin e procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidaten gjyqtare: {...}.

Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit!

Bashkëlidhur është edhe kërkesa për heqje dorë nga zonja {...}, dërguar me e-mail.

*Naureda Llagami:* Atëherë, nëse s’kemi diskutim, kalojmë në miratimin e opinionit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*Ilir Rusi:* Dakord.

*Irena Plaku:* Pro.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi opinionin mbi kandidatët që kanë aplikuar për t'u komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurave të komandimit nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale me vlerësimin e kritereve të tjera të komandimit për kandidaten gjyqtaren {...}.

\* \* \*

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 7 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit, z. {...}, aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).<sup>2</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)

<sup>2</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 8-ta sipas rendit të ditës.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit, z. {...}, aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

**Naureda Llagami:** Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 1/2023, ndaj magjistratit, z. {...}, aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Fjalën ia jap zotit Ridvan Hado.

**Ridvan Hado:** Faleminderit!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën e datës 27.02.2023 ka depozituar kërkesën ‘Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}, në funksionin gjyqtar

në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}', duke pretenduar shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 1, shkronja "dh" dhe neni 102, pika 2, shkronja "a", e ligjit 96/2016.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin që t'i caktohet gjyqtarit {...} masa disiplinore "Pezullim nga detyra për një periudhë prej 2 vitesh", të parashikuar nga neni 110 i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Me vendimin nr. 104, datë 06.03.2023, jam caktuar unë si relator i kësaj çështjeje.

Me faktet objekt procedimi jeni njohur. Po kaloj në procedurën formale.

Bazuar në nenin 31 të rregullores "Për procedurat disiplinore të Këshillit të Lartë Gjyqësor", janë verifikuar nga ana ime kriteret e nenit 139 të ligjit "Për statusin", që detyron Këshillin për mbylljen ose jo të procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore. Nuk jemi përpara parashkrimit të parashikuar nga neni 117. Jemi brenda afatit 5-vjeçar të parashkrimit, nga momenti i kryerjes së shkeljes së pretenduar nga Inspektorati. Po ashtu nuk rezulton që shkelja e pretenduar të ketë qenë objekt i ndonjë procedimi tjetër disiplinor, i mbyllur me vendim formës së prerë. Gjithashtu nuk jemi përpara kërkesave të parashikuara nga neni 64 dhe neni 67 i ligjit "Për statusin", pra nuk ka dhënë dorëheqjen magjistrati, nuk vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë apo papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; nuk ka mbushur moshën e pensionit 67 vjeç; nuk është shkarkuar nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit; ose nuk jemi para faktit të pamundësisë për të ushtruar detyrën. Gjithashtu nuk jemi përpara kërkesave të nenit 133, pika 3, pasi raporti është depozituar i arsyetuar me të gjithë elementët formal.

Në këto kushte, Komisioni Disiplinor, pas relatimit nga ana ime, në mbledhjen e datës 10.03.2023, vendosi kalimin e çështjes në mbledhjen plenare, pra të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të vendosur që të kalohet në seancë dëgjimore, caktimin e datës dhe orës për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, apo do mbyllet procedimi disiplinor pa caktuar seancë dëgjimore.

Nga ana ime i propozoj mbledhjes që të caktojme seancën dëgjimore. Sipas dispozitave ligjore seanca dëgjimore duhet brenda 1 muaji nga dita e regjistrimit dhe dita e regjistrimit është data 01.03.2023. Duhet respektuar edhe afati i njoftimit 15-ditor.

Në kushtet kur nga administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar raporti mjekoligjor i lëshuar nga komisioni, nga ku rezulton që magjistrati {...}, nga data 06.03.2023 është i paaftë për punë deri në datën 05.04.2023; në kushtet kur njëkohësisht kemi një procedim tjetër disiplinor, seanca e së cilës është caktuar në datën 05.04.2023, në orën 11:00, i propozoj mbledhjes plenare që edhe datën e kësaj seance dëgjimore ta caktojmë në datën 05.04.2023, orën pastaj përcaktojeni ju, përpara orës 11 apo më pas. Pas! Në orën 11:30.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, jeni dakord?

Kalojmë në votim.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e datës 05.04.2023, ora 11:30, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...} (procedim nr. 1/2023), aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.



\* \* \*

(Pika 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

**Pika 8 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit, z. {...}, aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).<sup>3</sup>

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)

<sup>3</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 9-ta sipas rendit të ditës.

**9. Brikena Ukperaj** (anëtare)

**10. Yllka Rupa** (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

**1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**

**2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**

**3. Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**

**5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**

**6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

#### **RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit, z. {...}, aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado).

**Naureda Llagami:** Kalojmë në caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, ndaj magjistratit, z. {...}.

Sërish relator është z. Ridvan Hado.

**Ridvan Hado:** Faleminderit!

Me shkresën e datës 27.02.2023, nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është paraqitur kërkesa ‘Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës’.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj gjyqtarit z. {...}, të masës disiplinore “Vërejtje publike” të parashikuar nga neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.

Me vendimin nr. 105, datë 06.03.2023, nga ky Këshill jam caktuar unë si relator i kësaj procedure.

Jeni njohur me faktet dhe rrethanat e procedimit disiplinor. Po ashtu nuk rezulton që të jemi përpara asnjërës prej pikave të nenit 139, pra nuk është parashkruar shkelja e pretenduar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë; nuk jemi përpara rastit që kjo shkelje të jetë gjykuar me vendim të formës së prerë; po ashtu nuk jemi përpara rasteve të parashikuara nga neni 64 dhe neni 67 i ligjit “Për statusin”; gjithashtu nuk jemi as përpara paragrafit të tretë të nenit 133, pasi vendimi ka ardhur i arsyetuar me të gjithë ekstremet ligjore.

Në këto kushte, në mbledhjen e datës 10.03.2023, Komisioni Disiplinor, pasi dëgjoi relatorin Ridvan Hado, i cili është i mendimit që t’ia kalojë mbledhjes plenare për të vendosur nëse do e kalojmë n seancë dëgjimore apo do mbyllet pa vendim. Si relator i këtij procedimi disiplinor (apo i kësaj procedure) i propozoj mbledhjes kalimin në seancë dëgjimore.

Siç thashë edhe tek procedimi tjetër, mund të anashkalojmë afatin njëmuor që kërkon ligji, për arsyet që i citova në procedimin tjetër, ngaqë nga ana e magjistratit {...} është paraqitur raport mjekoligjor, ku është i paaftë për punë nga data 06.03.2023 dhe i aftë për punë në datë 05.04.2023. Meqenëse dy procedime, sapo e kaluam tjetrin në seancë dëgjimore, po ashtu kemi edhe një tjetër të mëparshëm, mendoj dhe i propozoj mbledhjes që ta kalojmë edhe këtë procedim në seancë dëgjimore në datë 05.04.2023, në ora 12:00.

Ju faleminderit!

*Naureda Llagami*: Faleminderit zoti Hado!

Atëherë, nëse s’kemi diskutim, kalojmë në miratimin e projektpropozimit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e datës 05.04.2023, ora 12:00, si datë e zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...} (*procedim nr. 2/2023*), aktualisht me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

2. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

\* \* \*

(Pika 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 13.03.2023)*

***Pika 9 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro, në mungesë të z. Klodian Kurushi).<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:18 dhe mbaroi në orën 11:37.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Irena Plaku*** (anëtare)
- 5. Dritan Hallunaj*** (anëtar)
- 6. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 7. Alban Toro*** (anëtar)

<sup>4</sup> Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6-ta sipas rendit të ditës.

8. *Marçela Shehu* (anëtare)  
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)  
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. **Klodian Kurushi**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro, në mungesë të z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë tek akti tjetër që marrim në shqyrtim, që ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Alban Toro.

***Alban Toro***: Faleminderit!

Në mbledhjen plenare të datës 18.01.2023, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, me vendimet nr. 11 – nr. 24, datë 18.01.2023 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës.

Për procesin e lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, janë parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të të njëjtit nivel.

Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.

Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej 36 (tridhjetë e gjashtë) kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira fushën civile në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës të cituara si më sipër.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”. Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11 - nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun IV të vendimeve respektive nr. 11 - nr. 24 datë 18.01.2023, Këshilli ka përcaktuar procedurën përkatëse që do të ndiqet si më poshtë:

Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit;

b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;



c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij vendimi, proces ky që realizohet sipas kërkesave të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020.

Këshilli, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023 ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 11 – nr. 24, datë 18.01.2023, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi”.

Në shtojcën 1 paraqitet lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime:

1. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje;
2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin;
2. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
5. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
6. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
7. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë;
8. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;
9. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
10. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
11. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat;

12. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në këto kushte, në përputhje me pikën 9 të vendimeve, nr. 11 - nr. 24 datë 18.01.2023, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11 – nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

Projektvendimi është i strukturuar në 3 pika.

Në pikën e parë parashikohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11 - nr. 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

Në pikën e dytë, caktimin e relatorëve pas zhvillimit të procedurës së shortit për 14 kandidatët të cilët sipas shtojcës I të vendimit nr. 77, datë 13.02.2023, kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime: Znj. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Znj. {...}, Z. {...}, Z. {...}.

Lidhur me procedurën e shortit, do të jetë ajo e ndjekur në rastet e ngjashme. Në një enë të hidhen shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dhe në enën tjetër emrat e 14 (katërbëdhjetë) kandidatëve të cilët kanë aplikuar për procedurat e lëvizjes paralele. Më pas, shorti të vijojë me tërheqjen e një prej shiritave të letrës në enën me emrat e anëtarëve të Komisionit, i cili ngarkohet si relator për kandidatin përkatës të zgjedhur në vazhdim tjetër.

Komisioni propozon që secili prej anëtarëve të Komisionit të caktohet relator për 5 (pesë) kandidatë, ndërsa Kryetari i Komisionit caktohet për 4 (katër) kandidatë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe shoqërohet me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky ishte pak a shumë relacioni, ku bashkëlidhur do të gjeni edhe projektvendimin, të cilin ju ftoj ta miratojmë sipas propozimit të KZHK-së.

Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit zoti Toro!

Atëherë ftoj administratën për të vijuar me hedhjen e shortit, sipas sugjerimeve dhe rekomandimeve që është bërë në relacion.

Procedur a shortit si vijon:

Futet në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Klodian Kurushi, z. Dritan Hallunaj dhe z. Alban Toro.

Futen në enën tjetër të qelqit shiritat e letrës me emrat e kandidatëve: znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...}; znj. {...}; z. {...}; z. {...}; z. {...}.

Procedura e përzgjedhjes si vijon:

Përzgjidhet shiriti me emrin e relatorit të parë. Përzgjidhet zoti Hallunaj. Zoti Hallunaj do të jetë relator për 5 kandidatët e përzgjedhur si më poshtë: 5. {...}; 13. {...}; 10. {...}; 8. {...}; 4. {...}.

Përzgjidhet shiriti me emrin e relatorit të dytë. Përzgjidhet zoti Toro. Zoti Toro do të jetë relator për 5 kandidatët e përzgjedhur si më poshtë: 9. {...}; 14. {...}; 2. {...}; 12. {...}; 7. {...}.

Përzgjidhet shiriti me emrin e mbetur në enë, relatori z. Klodian Kurushi. Zoti Kurushi do të jetë relator për 4 kandidatët e përzgjedhur si më poshtë: 11. {...}; 1. {...}; 6. {...}; 3. {...}.

**Naureda Llagami:** Faleminderit!

Votojmë projekt-aktin?

**Brikena Ukperaj:** Pa kaluar në votim, duke qenë se projektvendimi i paraqitur për miratim nga KZHK-ja ka për qëllim fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës, për kandidatët që kanë dy ose mund të kenë dy vlerësime, për pozicionet e shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23, ky vendim nuk prodhon asnjë efekt sepse për këto dy pozicione s'ka asnjë kandidat që ka dy ose që mund të ketë dy

vlerësime. Konkretisht, për pozicionin nr. 22, kandidojnë {...}, {...}, {...}, {...}, të cilët janë në listën e kandidatëve që kanë një ose mund të ketë një vlerësim. Po kështu edhe për pozicionin nr. 23, nuk ka asnjë kandidat që ka dy vlerësime ose mund të ketë dy vlerësime. Në këto kushte, pozicioni nr. 22 dhe nr. 23, në titullin e projektvendimit dhe në pikën 1 të tij duhet të hiqen (mendoj unë). Për këto pozicione duhet të fillojë procedurë verifikimi për kandidatët që kanë një vlerësim ose mund të kenë një vlerësim.

(Zoti Toro flet pa ndezur mikrofonin.)

Alban, nuk ka nevojë ta konstatosh, sepse tek vendimi nr. 22 që ne kemi hapur shpalljen e procedurave për lëvizjen paralele dhe kemi thënë që në rast se në pozicion nuk ka kandidatë që ka apo mund të kenë, atëherë fillon procedura e lëvizjes për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik. Kështu që nuk mund ta themi që fillojnë për këta të dy dhe kemi këta gjyqtarë kur në këto dy pozicione ne s'kemi asnjë kandidat.

**Alban Toro:** Formalisht a do një vendimmarrje që s'ka për këto të dy? Dhe duke konstatuar këtë fakt, kalohet tek njëshi.

**Brikena Ukperaj:** Në kë vendimmarrje do ta bësh? Ti sot fillove procedurën. Ti sot fillove një procedurë individuale verifikimi për të gjithë kandidatët që kanë dy vlerësime ose jo. Ja, sot e konstatuam këtë gjë.

**Alban Toro:** Bëhet projektvendimi.

**Brikena Ukperaj:** Nuk ka projektvendim tjetër sepse automatikisht ti kur të vish tek tjetri do ta hapësh procedurën, nuk ke pse e vendos këtu 22-shin dhe 23-shin. Pra ti kur të vish me propozimin tjetër për fillimin e procedurës së verifikimit për kandidatët që kanë një ose mund të kenë një, i fut këta të dy.

**Alban Toro:** Procedura e ka që ne konstatojmë kush janë me dy ose mund të kenë dy. Në momentin që ne konstatojmë që 22-shi dhe 23-shi nuk kanë me dy, kalohet direkt

tek përcaktimi i relatorit për një ose ata që mund të kenë nj. Do bëjmë formalisht një vendimmarrje. Me çfarë akti e themi që 22-shi dhe 23-shi nuk kanë fare kandidatë?

(Zonja Shehu flet pa ndezur mikrofonin.)

**Marçela Shehu:** Si të jetë aty si mos të jetë aty nuk është se ndikon ndonjë gjë sepse verifikimi po bëhet për kandidatët, jo për pozicionin.

**Brikena Ukperaj:** Për këta kandidatë që po verifikohen, pozicioni nr. 22 dhe nr. 23 nuk kanë kandidatë me dy vlerësime. Nuk ka asnjë.

**Marçela Shehu:** Po! Jam dakord.

Por verifikimin ne po e bëjmë për kandidatët, nuk po e bëjmë për pozicionet.

Kam përshtypjen që janë vendosur të gjitha numrat e pozicioneve, jo se do bëhet verifikimi për kandidatët e atij pozicioni. Do bëhet verifikimi për të gjithë kandidatët që kanë dy vlerësime.

**Brikena Ukperaj:** Kështu e kupton ti aktin. Unë nuk e kuptoj kështu aktin.

Ti thua që fillojnë procedurat e vlerësimit për kriteret ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjes paralele në gjykatat... të shpallura me këto vendime, për kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i bie që në këto dy pozicione që do të fillosh një procedurë verifikimi për kandidatët, nuk ke asnjë kandidat me dy vlerësime. Pra në këto dy pozicione nr. 22 dhe nr. 23 nuk ka asnjë kandidat që ka ose mund të ketë 2 vlerësime.

**Marçela Shehu:** Unë mendoj që janë renditur formalisht sepse projektvendimi merr përsipër fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve për kandidatët, jo për pozicionet.

**Brikena Ukperaj:** Po!

Por këta kandidatë nuk janë në ajër.

Këta kandidatë kandidojnë në pozicione të caktuara.

**Marçela Shehu:** Po! Dhe në çdo relacion dhe në çdo projektvendim që do paraqitet për përmbushjen ose jo të kriterëve, do citohet nga Komisioni që kandidon për këto pozicione dhe i plotëson ose jo kriteret. Desha të them që, si të rrinë, si të mos rrinë, nuk është se afekton ndonjë gjë nga ana ligjore. Komisioni i ka vendosur formalisht dhe i ka përmendur të gjithë pozicionet që janë shpallur.

**Brikena Ukperaj:** Pikërisht, për të qenë në rregull dhe mos të jenë thjesht formal, 22-shi dhe 23-shi nuk mund të qëndrojnë.

**Marçela Shehu:** Si të hiqen, nuk është se afektojnë, mendoj unë.

*(Diskutojnë anëtarët pa ndezur mikrofonat.)*

**Naureda Llagami:** Kalojmë në votim projekt-aktin sipas Komisionit.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
3. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
4. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;
5. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;
6. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
7. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro;
8. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;
9. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro;
10. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;
11. Për kandidatin z. {...} - relator z. Klodian Kurushi;
12. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
13. Për kandidatin z. {...} - relator z. Dritan Hallunaj;
14. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban Toro;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po mbyllim mbledhjen për sot.

Ndërkohë që për 30 minuta të bëhet gati hedhja e shortit për caktimin e gjyqtarëve për gjykatat në nevojë.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**